


QKB

**DHOMA E NOTEREVE
TIRANE
Noter ERJON BARDHI
Rruga "KONGRESI
PERMETIT TIRANE"
Tel: 069 47 88 331**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANE
ZYRA NOTERISE TIRANE
NOTER ERJON B.BARDHI
NR. 6229 REP
NR. 2432 KOL**

Taksa e pulles e paguar.

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot më datë 08/10 /2019 (dymijë e nentembëdhjetë) para meje Noter **Erjon B.Bardhi** anëtar i Dhomës së Noterëve Tirane i regjistruar pranë Organeve Tatimore QKB me numer Nipti L62227014R ,në zyrën noteriale të ndodhur në "Rr.Kongresi i Permetit"Zogu i Zi,perballe Ring Center,Tirane u paraqiten personalisht palet e meposhtme te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje:

PALA SHITËSE: AGRON HASANKOLLI atesia **ALI** lindur me 11.05.1957 madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, lindur ne Floq,Korce dhe banues ne Tirane i pajisur me leternjoftim (ID) me Nr.F70511131C,me date leshimi 19.05.2010 ne cilesine e ortakut te 1 kuote me pjesemarrje ne perqindje 100 %(njqind perqind) te kapitalit themeltar te Shoqërise "ELEKTRO LUBONJA" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi");

jep pelqimin bashkeshortja: MERITA HASANKOLLI atesia **ZARIF** e lindur me 11.05.1960 madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, lindur ne Korce dhe banuese ne Tirane e pajisur me leternjoftim (ID) me Nr.G05511031A.

Personat e mesiperme jane bashkeshorte dhe jane ne dijeni per shitjen e kuotave te gjithsecilit dhe japin pelqimin per shitjen e kuotave te gjithsecilit dhe deklarojne se nuk kane dhe nuk do te kene asnje pretendim sot apo ne te ardhmen per shitjen e kuotave te konsideruara dhe bashkepronesi te percaktuara sipas dispozitave ligjore te koditt te familjes.

PALA E DYTE: 1-TAULANT KURTI atesia **BARDHYL** lindur me 20.10.1972 ne Berat dhe banues ne Njësia Bashkiake Nr.3,Tirane madhor me zotesi te plote jurike dhe per te vepruar i identifikuar me leternjoftimin me nr personal H21020047L me date leshimi 26.01.2010

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

PALA E DYTE: 2-ILIR BALA atesia **NASIP** lindur me 05.09.1974 ne Fier dhe banues ne Njësia Bashkiake Nr.10,Tirane madhor me zotesi te plote jurike dhe per te vepruar i identifikuar me leternjoftimin me nr personal H40905027S me date leshimi 28.04.2010 (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi");

MEQENESE:

Pala e pare AGRON HASANKOLLI eshte zoterues i nje kuote me 100%(njqind perqind)te kapitalit themeltar te Shoqërise "ELEKTRO LUBONJA" shpk me objekt aktiviteti "Prodhim i energjise elektrike me venien ne perdorim te hidrocentraleve ekzistuese dhe me ndertimin e hidrocentraleve te rinj te kapaciteteve te vegjel dhe te mesem 0.2-2.5 MWA

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësit dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE:

- A) Shitësi **AGRON HASANKOLLI** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 100 %(njqind perqind) te kapitalit themeltar te Shoqërise "ELEKTRO LUBONJA" shpk shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr NIPT (NUIS) **K94003002M**, me seli në Lagjia 7,Rruga 6 deshmoret,Pallati prapa Maternitet,Korce
- B) (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- C) Shitësi **AGRON HASANKOLLI** është ortak i vetem dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 100 %(njqindperqind) te kapitalit themeltar te Shoqërise **ELEKTRO LUBONJA" shpk** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me

**FIRMA
ELEKTRO LUBONJA
K94003002M**

DHOMA E NOTEREVE
TIRANE
Noter ERJON BARDHI
Rruga "KONGRESI
PERMETIT TIRANE"
Tel: 069 47 88 331

- nr NIPT (NUIS) K94003002M me seli në Lagjia 7,Rruga 6 deshmoret,Pallati prapa Maternitet,Korce (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- D) Blerësit TAULANT KURTI dhe ILIR BALA jane plotesisht dakord te blejne shoqerine e mesiperme dhe te zoterojne secili nga 1 kuote dhe konkretisht:
ILIR BALA 1 kuote me vlere te 66.67 % (gjashtedhete e gjashte pike gjashtedhete e shtate)perqind te kapitalit themeltar te **Shoqërise ELEKTRO LUBONJA" shpk**
TAULANT KURTI 1 kuote me vlere te 33.33 % (tridhete e tre pike tridhete e tre)perqind te kapitalit themeltar te **Shoqërise ELEKTRO LUBONJA" shpk** e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr NIPT (NUIS) K94003002M, me seli në Lagjia 7,Rruga 6 deshmoret,Pallati prapa Maternitet,Korce (në vijim referuar edhe si "Shoqëria");
- E) Shitësit dëshirojne t'i shesin Blerësve kuotat qe ata zoterojne te barabartë me 100% (njeqind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (në vijim referuar edhe si "Kuota"), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim;
- F) Blerësit dëshirojne të blejë nga Shitësit Kuotat e barabartë me 100% (njeqind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme;
- G) Palet deklarojne se me date 05.10/.2019 kane mbajtur nje mbledhje asmableje ku kane bere me dije paraprake fillimin e procedurave per transferimin e kuotes qe zoteron Z. **AGRON HASANKOLLI** tek zoti **TAULANT KURTI** dhe **ILIR BALA**

Palët, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATE

- 1.1** Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi **AGRON HASANKOLLI** deshiron te shese, te transferoje dhe dorezoje 1 (nje) kuote e barabarte me 100 %(njeqind) te kapitalit themeltar qe ai zoteron ne shoqerine **ELEKTRO LUBONJA" shpk** të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili, pranon dhe blen, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.
- 1.2** Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi **AGRON HASANKOLLI** deshiron te shese, te transferoje dhe dorezoje 1 (nje) kuote e barabarte me 100 %(njeqind) te kapitalit themeltar qe ajo zoteron ne shoqerine **ELEKTRO LUBONJA" shpk** të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësve, te cilet, pranojne dhe blejne, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë
- 1.3** Transferimi i titullit te kuotes do te behet pas kryerjes se te gjithë shumës ne llogarine bankare te Noterit **Erjon B.Bardhi**
- Pala shitëse merr përsipër dhe deklaron që shumën e parave e përcaktuar në nenin nenin 1 pika 3 të kësaj kontratë do i dorëzohet atij nga llogaria e noterit pasi pales blerëse ti kaloje pronesia sipas Udhëzimit te MF, MD nr. 6915/2, datë 30.1.2012 mbi procedurat teknike"per derdhjen e pageses se tjetersimit ne llogarine bankare te noterit", dhe te dyja palet nuk kane pretendime apo kontestime te tjera lidhur me cmimin dhe menyren e pageses si me lart deklaruar, dhe se pala blerëse nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj palës shitëse qe buron nga detyrimi për pagesën e çmimit të shitjes se pasurisë objekt i kësaj kontrate shitje.**
- Me nenshkrimin dhe dorezimin e kuotes tek bleresi, i cili merr persiper te gjitha te drejttat e shitesit dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise.


Palet bihen dakort se pagesa e çmimit do te behet sipas percaktimeve te nenit 3 te kesaj kontrate.

1.3 Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë **ELEKTRO LUBONJA" shpk** do te jete:

ILIR BALA zotërues i **1 (nje) kuote ne pjesemarrje** 66.67 % (gjashtedhete e gjashte pike gjashtedhete e shtate)perqind te kapitalit themeltar te **ELEKTRO LUBONJA" shpk**



FIRMA
ELEKTRO LUBONJA
K94003002M



**DHOMA E NOTEREVE
TIRANE
Noter ERJON BARDHI
Rruga "KONGRESI I
PERMETIT TIRANE"
Tel: 069 47 88 331**

TAULANT KURTI zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje 33.33 % (tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre) perqind te kapitalit themeltar te ELEKTRO LUBONJA" shpk

NENI 2

ÇMIMI

2.1 Çmimi i shitjes i pasurise objekt i kësaj kontrate shitje do te jete **9 223 700 (nente milion e dyqind e njetzet e tre mije e shtateqind)leke te reja**, shume e cila do te paguhet nga pala blerese ne favor te pales shitesese ne kete menyre: **Shuma prej 1 223 700 (nje milion e dyqind e njetzet e tre mije e shtateqind)leke te reja jane paguar nga pala blerese ne favor te pales shitesese ne monedhen euro dhe konkretisht ne shumen prej 10 000 (dhjete mije) euro e cila eshte paguar nga pala blerese ne favor te pales shitesese sipas kontrates se huase me nr rep 3891 kol 1591 date 05.07.2019 redaktuar nga noter Erjon Bardhi.**

Shuma prej 8 000 000 (tete milion)leke te reja do te paguhen nga pala blerese ne favor te pales shitesese ne llogarine bankare te Noterit Erjon B. BARDHI (OSSH) llogari tjetersimi i cili do tia transferoje pales shitesese z. **AGRON HASANKOLLI** ne llogarine e tij bankare me nr AL33 2124 1109 0000 0000 0027 2992 ose AL13 2121 1315 0000 0000 0127 0957 prane Bankes Credins vetem pasi Bleresve te jete regjistruar prane QKB-se si pronare te 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise **ELEKTRO LUBONJA" shpk**

NENI 3

DEKLARIME DHE GARANCI TË PALEVE

3.1 Shitësit garantojne blerësin se Kuotat objekt i kësaj Kontrate, jane te lira nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.

3.2 Blerësi deklaron se blen Kuotat e Shitësve, sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

3.3 Shitësit perkatesisht z. **AGRON HASANKOLLI** dhe **MERITA HASANKOLLI** e cila jep pelqimin ku bashkeshorti i saj eshte zoterues i 1 kuote e barazvlefshme me 100% e kapitalit themeltar i shoqerise **ELEKTRO LUBONJA" shpk** zoterues i 1 kuote e barazvlefshme me 100 % e kapitalit themeltar i shoqerise, me nenshkrimin e kesaj kontrates nuk kane dhe nuk do te kete asnje pretendim ne lidhje me (kuotat) qe zoteronin, dhe pronar te vetem dhe legjitim pa asnje barre dhe detyrim ndaj te treteve behet bleresit z. **TAULANT KURTI** dhe **ILIR BALA**

3.4 Pala shitëse garanton palën blerëse se nuk ka nenshkruar asnje kontrate qiraje, huaje, hipoteke, shitje, premtim shitje apo cdo akt noterial tjetër per kete pasuri dhe se mban pergjegjesi penale ne rast te kundert.

Pala shitëse deklaron se nuk ka detyrime ligjore dhe financaiare ndaj asnje personi fizik, juridik, individ, persona te trete duke perfshire, Fatura Tvsh-je, Paga puntore, Furnitore, Shoqerite qe mund te kene kryer punime etj dhe deklaron se merr persiper te gjitha detyrimet ne se do te kete ne te ardhmen per likujdimin e te gjitha detyrimeve.

Pala shitëse deklaron se nuk ka nenshkruar asnje marreveshje pengu mbi kuotat per llogari apo ne favor te banke te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise por jo vetem, cdo insitucioni finciar, apo dhe cdo personi juridik apo dhe fizik.

Pala shitëse deklaron se nuk ka nenshkruar asnje marreveshje pengu mbi kuotat per llogari apo ne favor te banke te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise por jo vetem, cdo insitucioni finciar, apo dhe cdo personi juridik apo dhe fizik. Kjo gje provohet dhe nga pergjigjet dhe verifikimi i bere prane RBS dhe QKB. Insitucione ku regjistrohen marreveshje pengu mbi kuotat. Bashkalidhur kesaj kontrate do te jete dhe Rezultatet e Kerkimit nga RBS dhe QKB)

3.5 Kjo kontrate do te jete e detyrueshme dhe do te kete pasoja juridike ndaj paleve, trashegimtareve te tyre, si dhe ndaj atyre te cileve iu eshte ceduar ne menyre te rregullt, (Duke mos patur asnje pretendim qofte dhe gjyqesisht as tani dhe as ne te ardhmen. Me nenshkrimin e kesaj kontrate deklarojne dhe garantojne dhe ne emer te trashegimtareve te tyre, si dhe ndaj atyre te

DHOMA E NOTEREVE
TIRANE
Noter ERJON BARDHI
Rruga "KONGRESI I
PERMETIT TIRANE"
Tel: 069 47 88 331

cileve iu eshte ceduar ne menyre te rregullt nuk do te ngrejne pretendime mbi shitjen e ketyre kuotave as tani dhe as ne te ardhmen dhe nuk do t'i kerkojne ato qofte dhe gjyqesisht)

3.6 Kjo Kontrate perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Shitesin dhe per Bleresit.

3.7 Palet deklarojne se me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje nuk do te kene detyrime te ndersjellta ndermjet njeri tjetrit pervec likujdimit te cmimit te shitjes se kuotave.

NENI 4

SHPENZIMET DHE TAKSAT

4.1 Tatimi mbi fitimin e shitjes(tatimin ne burim)qe vjen nga shitja e kuotes do te paguhet nga pala Shitese

4.2 Shpenzimet ligjore,shpenzimet noteriale, tarifat e regjistrimit ne zyrat kompetente si dhe cdo shpenzim tjetër administrative që lidhet me këtë kontratë,regjistrimin e saj ne QKB do të jenë në ngarkim të Blerësit.

NENI 5

INTERPRETIMI I KONTRATËS

5.1 Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

5.2 Nese pjese te kesaj kontrate jane ose behen te pavlefshme ose jodetyruese, palet do te jene te detyruara te zbatojne pjesen tjetere te kontrates, Ne kete rast, palet do te zvendesoje pjesen e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime te vlefshme e detyruese efektet e te cilave sipas permbajtjes dhe qellimeve te kesaj kontrate duhet te jene ne kufijte e te mundshmes, e ngjashme me pjesen e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 6

LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET

6.1 Problemet ne lidhje me ceshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.

6.2 Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

6.3 Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Paleve.

NENI 7

PËRMBAJTJA E KONTRATËS DHE NDRYSHIMET



Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e kuotave perkatesisht 1 kuote e barazvlefshme me 100 % e kapitalit themeltar i shoqerise qe zoteron z. **AGRON HASANKOLLI**, te shoqeria **ELEKTRO LUBONJA** shpk, tek Blerësit dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklarimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

NENI 8

ANEKSET E KONTRATES

Kesaj kontrate i bashkengjiten si pjese perberese dhe te pandara keto dokumenta qe do te quhen Aneke te kontrates. **Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:**

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregetar



DHOMA E NOTEREVE
TIRANE
Noter ERJON BARDHI
Rruga "KONGRESI
PERMETIT TIRANE"
Tel: 069 47 88 331

- Pergjigje derguar nga Regjistri I Bares Siguruese
- Vendimet e Asamblese se Pergjithshme.
- Kopje te leternjoftimeve te personave nenshkrues
- **Kopje origjinale te Rezultatit te kerkimit ne RBS -e QKB**

Unë noter Erjon B.Bardhi, hartova këtë kontratë, në 5(pese) kopje ne gjuhën shqipe, që pasi u lexua nga ana ime dhe palët pjesëmarrëse, të cilat deklaruan para meje së është konform vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar, në shenjë pranimi e nënshkruan në praninë time. Duke qenë i bindur për identitetin e palëve dhe vullnetin e tyre të lirë unë Noter **Erjon B.Bardhi** e legalizoj aktin e mësipërm në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin me nr 110/2018 date 20.12.2018 "Për Noterinë" **në 5(pese) kopje** me vlerë të njëjtë, me nga **5 (pese) faqe** secila, nga të cilat, nje kopje dorezohet prane QKB-se, dy kopje i jepen palës blerëse, nje kopje palës shitëse dhe një kopje administrohet nga ana ime,prane kesaj zyre Noterie.

PALET KONTRAKTUESE

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:

PALA SHITËSE
AGRON HASANKOLLI

(zoterues i 1 kuote e barazvlefshme me 100% te kapitalit)

Agrom Hasankolli
Agrom

Jep pelqimin bashkeshortja:
MERITA HASANKOLLI

Merita Hasankolli
Mer

FIRMA
ELEKTROLUBONIA
K9490:302M

NOTER
ERJON B.BARDHI

Erjon Bardhi



PALA BLERËSE
TAULANT KURTI

Taulant Kurti
T.K.

ILIR BALA

Ilir Bala
Ilir Bala

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2019100311485118
Data e Rezultatit të Kërkimit: 03.10.2019
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 11:48:05AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-613-3520
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

AGRON ALI HASANKOLLI
ELEKTRO LUBONJA SH.P.K.



Aranda Lekku